



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201500801/24

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda:** *Rekomandohet miratimi i ndihmës financiare në masën e katër pagave mujore për ushtarakun P. L.*

**Drejtuar:** **Ministrit të Financave**  
Z. Arben AHMETAJ

**TIRANË**

*I nderuar Z. Ahmetaj,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi P.L.i, ish efektiv i Repartit nr.3005 Kuçovë, i cili pretendon se nuk ka marrë ende ndihmën financiare në masën 5 paga mujore për shkak të probleme shëndetësore që ai ka patur gjatë detyrës. Sipas Urdhërit Nr.1214, datë 23.07.2015 të Zv/Ministrit të Mbrojtjes, ushtarakut në fjalë duhet ti jepet ndihmë financiare për shkak të sëmundjes së rëndë e të gjatë në masën 5 paga mujore. Shpenzimet për ndihmën financiare duhet të përballoheshin nga fondi i veçantë i vitit 2015 i Komandës së Forcës Ajrore.

Për verifikimin e kësaj ankese fillimisht jemi interesuar në Komandën e Forcës Ajrore. Në përgjigjen e kësaj Komande u informuam se, Ministria e Financës ka miratuar dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme për Rreshter P. L. vetëm në masën e një page mujore në vlerën 48.200 lekë.

Më pas iu drejtua Ministrisë së Financës duke kërkuar të merrnim përgjigje se cila kishte qenë aryeja e mosmiratimit të pesë pagave ndihmë për ushtarakun dhe si do të veprohej në këto raste nëse fondi i veçantë i njësisë shpenzuese për një vit të caktuar nuk ishte i mjaftueshëm për të shlyer të plotë ndihmën financiare të miratuar nga titullari i institucionit qëndror.

Në përgjigjen e Ministrisë së Financës ardhur me shkresën Nr. 8022/1 prot., datë 18.07.2016, thuhet se, për shkak të zvogëlimit të fondit të veçantë për buxhetin 2015 është vlerësuar të miratohet vetëm një pagë mujore ndihmë për ushtarakun dhe se referuar Ligjit nr.160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", fondi i veçantë përdoret me miratimin e Ministrisë së Financave.

Pasi analizuam në tërësi legjislacionin e zbatuar për këtë rast rezultoi se, ushtaraku P. L. duhet të përfitonte ndihmë financiare për shkak të sëmundjes në masën e pesë pagave mujore. Në pikën 7 të VKM Nr.929, dt.17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar, parashikohet dhënia e ndihmës së menjëhershme për rastet kur punonjësi pëson sëmundje të rëndë. Për rastet e përmendura në paragrafët 2-5 të pikës 7, ndihma që do ti jepet përfituesit nuk mund të kalojë shumën 30000 ose 50000 lekë apo masën e një page mujore. Ndërsa në paragrafin e fundit të pikës 7, parashikohet se: "për rastet kur, sipas ligjeve të veçanta, linden të drejta specifike të dhënies së ndihmave të

*menjëhershme, masa e ndihmës së dhënë përballohet nga fondi i veçantë, i përlogaritur sipas pikës 1 të këtij vendimi". Pra, për subjektet që përfitojnë ndihmë nga ligje të veçanta nuk përcaktohet limiti në masën e ndihmës siç përcaktohet për rastet e tjera të përmendura në VKM. Limiti i ndihmës përcaktohet në ligjin e veçantë. Rreshter P. L. ka përfituar ndihmë të menjëhershme financiare në masën 5 paga mujore në bazë të një ligji të veçantë, Ligji Nr. 9210, datë 23.03.2004 "Për Statusin e Ushtarakut të FA". Në nenin 30, pika 1 të këtij ligji thuhet se: "Në rastet kur ushtaraku aktiv (oficeri, nënoficeri, ushtari me pagesë/profesionist) i Forcave të Armatosura vdes, pëson sëmundje të rëndë e të gjatë ose dëmtime të mëdha të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, familjes ose atij i jepet ndihmë financiare e menjëhershme në masën deri në gjashtë paga mujore". Pamjaftueshmëria e fondit të veçantë për një vit buxhetor për të miratuar të plotë ndihmën financiare të dhënë sipas ligjit të veçantë nuk do të thotë që kjo ndihmë të mos i jepet asnjëherë përfituesit. Ndihma e plotë mund të jepet në vitin e ardhshëm buxhetorë. Ligji Nr.160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015", në nenin 11 përcakton se fondi i veçantë përdoret me miratimin e Ministrisë së Financave por, Ministria e Financave gjatë zbatimit të kësaj norme duhet të ketë parasysht edhe normat që përcaktohen në ligje të veçanta. Nëse i referohemi praktikës së Gjykatës Kushtetuese, në disa vendime ajo është shprehur për hierarkinë ndërmjet ligjeve. Në rast konflikti normash juridike zbatohen parimet e shtetit të së drejtës dhe të koherencës në sistemin ligjor që, në këtë rast është parimi "lex specialis derogat generali", sipas të cilit norma e veçantë ka përparësi nga norma e përgjithshme (vendimet nr.2 dt. 03.02.2010 fq. 7 dhe nr. 16 dt. 27.03.2012 fq. 9).*

Meqenëse ushtaraku P. L. ka përfituar ndihmë financiare një pagë mujore atij i takon të përfitojë edhe katër paga të tjera mujore për sëmundjen që ka pësuar gjatë detyrës.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive."

## **J U R E K O M A N D O J M Ë:**

Miratimin e ndihmës financiare në masën e katër pagave mujore për ushtarakun P. L.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**

**Në Mungesë  
dhe me Porosi**

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**